



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____ /2019

Dt. 25.04.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 9.2 dhe 13 të Rregullores 01 nr. 011-11268/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 07.07.2014, në mbledhjen e mbajtur me dt.25.04.2019, pas diskutimeve lidhur më pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve në vlerë prej 4.000€ Ansambllit Muzikor të Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Apropohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 4.000€ Ansambllit Muzikor të Komunës së Gjakovës, për vitin 2019.
2. Mjetet financiare në vlerë prej 4.000€ të mirën nga kategoria e subvencioneve në buxhetin e Drejtorisë për Kulturë Rini, dhe Sport.
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e programit të Ansambllit Muzikor të Komunës së Gjakovës në bazë të kërkesave nga Plan projekti për Koncertet për vitin 2019.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini,
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa
 - Ansambllit Muzikor të Komunës së Gjakovës
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës,

Anton Shala